



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 20.06.2025
Numër Protokolli: 4244/2025

A.nr.648/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.648/2025, të datës 14.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, D.L, kundër organit të punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.06.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A. nr.648/2025, të datës 14.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, D.L.

II.Mbetët në fuqi Njoftimi i datës 13.03.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Ankuesja, D.L (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 14.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2459/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.648/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN0001637, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 17.01.2025, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Skema Pensionale”, klasa e pozitës Profesional 1.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit, më datë 08.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.Kryetari i

Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3533/2025 të datës 27.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 2459/2025 të parashtruar nga ankuesja më datë 14.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit; Kopja e konkursit me numër reference RN00016370; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.04.2025;

Përgjigje në ankesë e datës e datës 08.05.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Vendimi i datës 05.03.2025 me nr.76/2025 për themelimin e komisionit të vlerësimit për pranimit: Aplikacioni i datës 02.02.2025 për kandidatin D.L bashkë me dokumentacionin; Njoftimi i datës 27.02.2025 për refuzimin e aplikacionit; Lista e aplikantëve; Lista e kandidatëve të aprovuar; Lista e kandidatëve të refuzuar; Njoftimi i datës 27.02.2025 për kandidatët që kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak; Njoftimi i datës 13.03.2025 nga NJBNJ në Ministrinë e Financave , Punës dhe Transfereve për kandidatin fitues; Lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Akt Emërimi me nr.125/2024 i datës 01.04.2024; Akt Emërimi i datës 30.09.2024; Akt Emërimi i datës 01.04.2024; Akt Emërimi i datës 12.08.2024; Akt Emërimi i datës 13.09.2024; Testimi elektronik për D.Alidemi; Aplikacioni i datës 16.02.2025 për kandidatin A.D.S; Aplikacioni i datës 21.01.2025 për kandidatin A.M; Aplikacioni i datës 29.01.2025 për kandidatin A.S.B; Aplikacioni i datës 22.01.2025 për kandidatin A.M; Aplikacioni i datës 31.01.2025 për kandidatin A.I; Aplikacioni i datës 12.02.2025 për kandidatin A.H; Aplikacioni i datës 19.01.2025 për kandidatin A.K; Aplikacioni i datës 23.01.2025 për kandidatin A.S; Aplikacioni i datës 30.01.2025 për kandidatin B.B; Aplikacioni i datës 05.02.2025 për kandidatin B.SH.R; Aplikacioni i datës 20.01.2025 për kandidatin D.A; Aplikacioni i datës 21.01.2025 për kandidatin F.B; Aplikacioni i datës 22.01.2025 për kandidatin F.SH.H; Aplikacioni i datës 20.01.2025 për kandidatin G.R.K; Aplikacioni i datës 14.02.2025 për kandidatin H.M; Aplikacioni i datës 21.01.2025 për kandidatin J.I; Aplikacioni i datës 24.01.2025 për kandidatin K.M; Aplikacioni i datës 20.01.2025 për kandidatin K.S; Aplikacioni i datës 21.01.2025 për kandidatin L.M; Aplikacioni i datës 05.02.2025 për kandidatin L.Z; Aplikacioni i datës 27.01.2025 për kandidatin M.H; Aplikacioni i datës 18.01.2025 për kandidatin P.P; Aplikacioni i datës 28.01.2025 për kandidatin P.S; Aplikacioni i datës 19.01.2025 për kandidatin P.S; Aplikacioni i datës 20.01.2025 për kandidatin P.V; Aplikacioni i datës 22.01.2025 për kandidatin P.A; Aplikacioni i datës 20.01.2025 për kandidatin Q.Sh; Aplikacioni i datës 11.02.2025 për kandidatin Q.Sh; Aplikacioni i datës 05.02.2025 për kandidatin R.J; Aplikacioni i datës 28.01.2025 për kandidatin R.A.; Aplikacioni i datës 20.01.2025 për kandidatin R.N; Aplikacioni i datës 15.02.2025 për kandidatin S.S; Aplikacioni i datës 11.02.2025 për kandidatin Sh.Z; Aplikacioni i datës 03.02.2025 për kandidatin V.S; Aplikacioni i datës 23.01.2025 për kandidatin Y.U; Aplikacioni i datës 09.02.2025 për kandidatin V.T; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarëve të Komisionit për kandidatin në intervistë të datës 13.03.2025; Formularët e Vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga Komisioni i Pranimit të datës 10.03.2025.

Kolegji pas shqyrtimit të gjitha provave të bashkëngjitura nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, sepse:

Kolegji ka analizuar konkursin e datës 17.01.2025, me afat aplikimit nga data 18.01.2025 deri më datë 16.02.2025 për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm pozita “Zyrtar i Lartë për Skema Pensionale” klasa Proefesional 1 dhe ka konstatuar se konkursi është shpallur në përputhje me Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës dhe

se kriteret formale të konkursit kanë qenë në harmoni me shtojcën nr. 1/5 të Rregullores së lartë cekur gjegjësisht: **Kërkesat e përgjithshme formale: Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Kërkesat specifike: nuk ka, Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës**”, gjithashtu konkursi është në përputhje edhe me katalogun e vendeve të punës sipas Katalogut të Punës për Shërbimin Civil i miratuar me Vendimin Nr.08/226 të datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, prandaj Kolegji konstaton se konkursi për pozitën “Zyrtar i Lartë për Skema Pensionale është shpallur në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji lidhur me këtë konkurs me qëllim të evitimit të gjitha dilemave dha pa qartësie sa i përket pretendimeve ankimore të ankueses ka trajtuar të gjitha njoftimet e Njësisë së Burimeve Njerëzore të MFPT sa i përket aplikantëve të cilët në fazën e verifikimit paraprak janë refuzuar, Kolegji ka konstatuar se nga këto njoftime për refuzim nuk ka gjetur se është zbatuar apo kufizuar aplikimi i ligjit në dëm të kandidatëve që kanë aplikuar dhe janë refuzuar, respektivisht kandidatët janë refuzuar duke u mbështetur në kriteret e formale të konkursit të shpallur me datë 17.01.2025 nr. RN00016370

Ndërsa, në kuptim të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Neni 9 par. 1, 2: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj. 2.Përgjithimisht, për pozita specifike të zyrtarëve publik, mund të kërkojnë kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministritë përgjegjëse për administratë publike.*

-Neni 10: *“Në institucionet publike qendrore, minimum dhjetë për qind (10%) e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë”.*

Neni 39: *1.Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së”, 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjithimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë*

(30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësi përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi....”

Si rrjedhojë, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës Kolegji ka gjetur se është i bazuar pretendimi ankimor i ankueses se kandidati i shpallur fituese nuk ka përvojën e punës. Rrjedhimisht, Kolegji në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të kandidateve fitues (përfshirë ankuesen) nga dhe ka vërejtur këtë gjendje të fakteve:

Më tutje Kolegji ka trajtuar pretendimet e ankueses dhe ka konstatuar se ankuesja D.L nga shkresat e lëndës së bashkëngjitura nuk ka plotësuar përvojën e punës sipas kriterëve të parapara në konkurs, sepse e njëjta, posedon Diplomën e datës 22.10.2019 të lëshuar nga Universiteti publik “Kadri Zeka” në Gjilan dhe mori titullin Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet, dhe ka këtë përvojë pune: prej datës 03.04.2023 -31.03.2024 ka punuar punë praktike në Departamentin e Administratës Pensionale-Zyra Regjionale në Gjilan, gjatë periudhës 08/2022-01/2023 ka kryer punë praktike në Agjencinë e Statistikave të Kosovës e cila nuk llogaritet si përvojë profesionale, dhe përvojën e punës në Komtel-Project Engineering, gjatë periudhës 06/2021-11/2021, gjithsejtë 6 muaj nuk e dëshmonë me dëshmitë e punësimit :kontrata, vërtetime dhe Akt Emërimin në pozitën Zyrtar i Tatimit në pronë në Komunën e Gjilanit duke filluar nga data 20.01.2025-deri më datë 27.02.2025 deri në datën e njoftimit paraprak,, andaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se e njëjta nuk i ka dy vjet pune profesionale ashtu siç kërkohet në kriteret e përgjithshme formale të konkursit të shpallur me datë 17.01.2025 nga Ministria e Financave ,Punës dhe Transfereve.

Ndërsa për kandidaten fituese znj.Dijana Alidemi kolegji ka konstatuar se e njëjta posedon Diplomën e datës 03.05.2018 të lëshuar nga Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” dhe mori titullin Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe me këtë përvojë pune: prej datës 03.03.2018 deri më datën 31.12.2021 në pozitën Përgjegjëse e arkës dhe Konsulente e shitjes në “Gama Elektronics”, punë praktike -Shpedicioni -NTP”Jona”prej datës 03.01.2022-01.07.2022 dhe prej datës 05.12.2022-05.12.2023 punë praktike në Administratën e Pensioneve në Gjilan. Andaj Kolegji ka konstatuar se e njëjta ka plotësuar kriteret e konkursit për pozitën Zyrtare e Lartë për Skema Pensionale dhe është radhitur kandidate fituese e radhitur e para me gjithsejtë 85.4 pikë.

Andaj, duke u bazuar në rrethanat dhe konstatimet e më sipërme të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 132, paragrafi 4 të, ku përcaktohet se: *Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulohet apo ndryshohet, plotësisht apo pjesërisht, aktin e animuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.,* dhe bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A. nr.648/2025, të datës 14.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, D.L dhe të mbetet në fuqi Njoftimi i datës 13.03.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Theksuar si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e

Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për refuzimin e ankesës si të pabazuar, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.648/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses D.L;
- Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.